

## 1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2015

*Tabelë 1:* Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në milionë lekë\*)

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO njëmujore	R/REPO tremujore
02.07.2015		23,500.00	4,000.00	
09.07.2015		16,800.00	3,750.00	
16.07.2015		23,600.00	4,000.00	
23.07.2015		26,370.00	3,790.00	
24.07.2015				2,450.00
30.07.2015		23,500.00	4,000.00	
06.08.2015		24,080.00	4,000.00	
13.08.2015		19,970.00	4,000.00	
20.08.2015		27,790.00	3,900.00	
24.08.2015				1,500.00
27.08.2015		21,900.00	4,000.00	
03.09.2015		20,010.00	4,000.00	
10.09.2015		18,580.00	4,000.00	
17.09.2015		22,910.00	3,950.00	
23.09.2015	5,740.00			
25.09.2015		18,840.00	3,880.00	1,760.00

### 1.1. Operacione të tregut të hapur

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2015 përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektim të përkohshëm të likuiditetit.

**Sasia totale e likuiditetit të injektuar ka rezultuar mesatarisht 36.4 mld lek kundrejt 28.4 miliardë lekë në tremujorin e mëparshëm dhe 30.2 miliardë lekë një vit më parë.**

Për injektimin e likuiditetit të përkohshëm, Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor në mesatarisht 22.14 miliardë lekë, kundrejt mesatarisht 19.50 miliardë lekë në javë\* në tremujorin e mëparshëm, ndërsa injektimet njëmujore kanë qenë mesatarisht 3.94 miliardë lekë, kundrejt 3.28 miliardë lekë në javë\* në tremujorin e dytë. Prej fundit të muajit korrik, Banka e Shqipërisë ka kryer injektime 3-mujore në 3 raste, duke bërë që

likuiditeti mesatar i injektuar nëpërmjet këtij maturimi në tremujorin aktual të jetë 2.55 miliardë lekë në vlerë nominale dhe 5.7 miliardë lekë në fund të tij.

**Operacioni injektues njëditor është përdorur vetëm në një rast, në datën 23 shtator në fund të periudhës së mbajtjes së rezervës.**

Gjatë tremujorit të tretë, Banka e Shqipërisë nuk ka kryer operacione blerjeje dhe shitjeje të letrave me vlerë.


### 1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Bankat kanë përdorur depozitën njëditore vetëm në dy raste, kundrejt 11 rasteve një tremujor më parë dhe shuma mesatare e përdorimit të saj qe 2.0 miliardë lekë, kundrejt 0.95 miliardë lekëve në tremujorin e dytë. Kredia njëditore është përdorur në dy raste për mesatarisht 1.4 miliardë lekë, kundrejt 3 rasteve dhe mesatarisht 1.0 miliardë lekë një tremujor më parë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblodhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për periudhën 2009-2015.

\* Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale.

**Grafik 1:** Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2009-2015 (me vlerë nominale)




## 2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2015

### 2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2015, Banka e Shqipërisë ka realizuar dy ankandet e planifikuara të muajve korrik dhe gusht për blerjen e valutës me objektiv rritjen e rezervës valutore. Shuma e shpallur për blerje për secilin nga këto ankande qe 2-5 milionë euro. Shuma totale e blerë në të dy ankandet ishte 7.0 milionë euro. Pas ankandit të muajit korrik janë blerë edhe 6.3 milionë euro nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe me bankat e nivelit të dytë.

**Grafik 2:** Ecuria e EUR/ALL dhe USD/ALL në tremujorin e tretë të vitit 2015



**2.2 Veprime me institucione të tjera**

Në tremujorin e tretë të vitit kanë vazhduar të lidhen marrëveshjet *swap* në valutë, kundrejt lekut midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, sipas kërkesave të kësaj të fundit që synojnë menaxhimin sa më të mirë të likuiditetit të saj. Si rezultat i marrëveshjeve *swap* të lidhura në tremujorin e tretë, kundravlehtë në lekë e blerjeve të valutës së Bankës së Shqipërisë nga Ministria e Financave gjatë kësaj periudhe qe 24,390.30 milionë lekë, ndërsa e shitjeve qe 24,463.23 milionë lekë. Shumat e investuara në marrëveshjet *swap* erdhën në rënie në 65 milionë SDR në fund të tremujorit të tretë nga 74 milionë SDR në fund të tremujorit të dytë, ndërkohë që u maturuan marrëveshjet *swap* në euro nga 18 milionë euro që ishin në fund të tremujorit të dytë.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 70.98 milionë lekë (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – IBRD dhe Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA).

**Tabelë 2:** Veprime valutore me institucione të tjera

<b>Institucioni financiar</b>	<b>Blerje të valutës (në milionë lekë)</b>	<b>Shitje të valutës (në milionë lekë)</b>
MINISTRIA E FINANCAVE	24,390.30	24,463.23
TË TJERA (IDA, IBRD)	70.98	